

## ARSIMI SHQIP NË KOSOVË, 1990-1999, SHTËPITË-SHKOLLA

Studiuesi i njohur Bajram Shatri është një autor i njohur jo vetëm në Kosovë, por edhe më gjerë e veçanërisht në Tiranë, si njohës i thellë dhe studiues i përkushtuar.

Një kuadër i të gjitha përpjekjeve të pashembullta për vijimin e shkollës shqipe, paraqitet në librin e tij kur, ndonëse shkollat u dogjën e u shkatërruan, mësimi u zhvillua në shtëpitë, shkollat që liruan e rregulluan patriotët e kësaj treve heroike. Libri “Arsimi shqip në Kosovë, 1990-1999”, na njeh me sfidat e shumta që po kalonte arsimit dhe shkolla si dhe me arritjet dhe aspiratat për të ardhmen e nxënësve dhe studentëve atje.

Libri na njeh me ndihmesën e punëtorëve të arsimit, me rolin e nxënësve dhe të studentëve, me kontributin e të gjithë atyre kryefamiljarëve të cilët i lëshuan shtëpitë që të shndërrohen në shkolla, me kontributin e institucioneve profesionale në funksion të arsimit, me kontributin e individëve në krye të institucioneve, të cilët vazhdimisht ishin në ballë të mbrojtjes dhe të udhëheqjes së arsimit, me kontributin e partive politike dhe të shoqatave joqeveritare. Punëtorët e arsimit vazhdimisht, në rrethana okupuese, i edukuan dhe i arsimuan nxënësit dhe studentët, të uritur, të zbathur, të leckosur, të rrahur nga policia serbe dhe të vrarë.

Libri paraqet me modesti rolin e arsimit dhe kontributin e të gjithë atyre kryefamiljarëve që i lëshuan shtëpitë për shkollën shqipe, por, meqë deri më tani pak është shkruar në këtë fushë dhe për të mos e kapluar pluhuri i harresës, autori bën përpjekje të shkruajë për atë që di, si njëri ndër aktorët e këtyre rrjedhave.

Kjo monografi u është kushtuar të gjithë atyre që flijuan jetën dhe familjet e tyre për të mbijetuar arsimit shqiptar në Kosovë edhe në kushte dhe rrethana të jashtëzakonshme që askush nuk kishte mundur t'i ëndërronte, për të cilën Barjam Shutzi i ri ka punuar

shumë vite me radhë. Ai hulumtoi nëpër arkiva të shkollave, në Arkivin e Kosovës mblodhi shënime nga përgjegjësit e arsimit në komunat përkatëse, shfrytëzoi shënime të mbledhura nga kryefamiljarët dhe nga shumë e shumë veprimtarë të tjerë.

Shënime për nxënësit, arsimtarët, kryefamiljarët që i kanë lëshuar shtëpitë e tyre për mbajtjen e procesit mësimor, i ka siguruar në shumë mënyra. Shënime për secilën shkollë fillore, shkollë të mesme dhe fakultete autori i ka ruajtur me kujdes. Ka pasur besimin të jetë sekretar i Këshillit Qendror të Financimit të Arsimit të Kosovës për tri vite me radhë. Këshilli Qendror për Financim i Kosovës për nevoja të veta ka grumbulluar të dhëna të shumta për nxënësit dhe për arsimtarët. Me këto shënime të domosdoshme për financim janë kërkuar edhe shënime për kryefamiljarët, të cilët i kanë lëshuar shtëpitë për organizimin e mësimin, qoftë në shkolla fillore, qoftë në shkolla të mesme. E njëjta kërkesë ka qenë edhe për shkolla të larta dhe për fakultete si dhe për institucionet shkencore, Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, Institutin Albanologjik, Institutin e Historisë, Institutin Ekonomik, Institutin Pedagogjik, Shtëpinë Botuese të Librit Shkollor, për arsimin kombëtar shqiptar, veçanërisht në vitet e vështira kur Kosova po luftonte për lirinë dhe të drejtat e saj, për çlirim nga mizoria serbe dhe për gjuhën dhe kulturën e saj.

Kushtet e punës në këto shtëpi nuk ishin të përshtatshme, ngaqë nuk kishte inventar të domosdoshëm, nuk kishte banka dhe karrige, por me kalimin e kohës edhe në shtëpi-shkolla u bënë meremetime dhe përshtatje të konsiderueshme. Vlen të ceket se, gjatë këtyre viteve, një numër i madh i shkollave ekzistuese u meremetuan, u riparuan, edhe një pjesë e tyre në të gjitha komunat e Kosovës, ku më pak e ku më shumë u ngritën objektet e reja shkollore me vetëkontribut të komunitetit dhe të ndihmuar nga fondi i Këshillit Qendror të Financimit të Kosovës. Gjatë atyre 8 viteve të punës jashtë objekteve shkollore, shtëpitë e tyre i kanë liruar mbi 3.200 kryefamiljarë.

Disa nxënësit të shkollave fillore dhe të shkollave të mesme si dhe studentët e shkollave të larta dhe të fakulteteve, sipas Marrëveshjes së vitit 1996, janë kthyer në objektet e tyre shkollore në vitin 1997 dhe 1998. Në vitin 1998, për shkak të shtrirjes së

luftës në tërë territorin e Kosovës, posaçërisht në Drenicë dhe Dukagjin, shumë shkolla u dogjën dhe u shkatërruan. Në këto zona, procesi mësimor, sidomos në shkolla fillore, u organizua në shtëpi private, në Prizren Gjakovë etj., ndërsa një numër i madh i nxënësve u sistemuan në zonat më të sigurta, sidomos në qytete më të mëdha, Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Prizren etj. Në disa zona të Drenicës, në të cilat popullata ishte sistemuar nëpër tenda në fusha dhe pyje, procesi mësimor u organizua në tenda, në kushte tejet të vështira.

Me dëbimin masiv të popullit shqiptar nga trojet shekullore dhe të sistemimit në shtetet fqinjë Shqipëri, Maqedoni dhe Mal të Zi, edhe pse në kushte shumë të vështira për jetën, u organizua procesi mësimor për nxënës të shkollave fillore dhe të shkollave të mesme. Mjerisht, për këtë ka fare pak informacione në formë elektronike. Në Mal të Zi, veprimtaria mësimore u zhvillua sidomos në Ulqin, Gusi, Plavë etj. Procesi mësimor për nxënës të shkollës fillore dhe të shkollës së mesme u organizua edhe në Shqipëri dhe në Maqedoni. Bartës i organizimit të mësimin në këto shtete ishte Sindikata e Bashkuar e Arsimit të Kosovës.

Në Shtator të vitit 1999, të gjithë nxënësit e shkollave fillore dhe të shkollave të mesme si dhe të gjithë studentët e shkollave të larta dhe të fakulteteve u kthyen në objektet e tyre shkollore, me përjashtim të shkollave fillore, shkollave të mesme (Shkolla e Mesme e Mjekësisë dhe Shkolla e Mesme Teknike) në pjesën veriore të Mitrovicës, Shkollës së Lartë Teknike në Svegjan, Fakultetit të Xehetarisë dhe të Metalurgjisë në Mitrovicë, të cilëve iu pamundësua kthimi në objektet e tyre shkollore.

Libri është i pajisur me lista, grafikë dhe dokumente, ku jepen emrat e gjithë veprimtarëve të arsimit në këto vite, fotografi dhe jetëshkrime të kryefamiljarëve që lëshuan shtëpitë, të cilat dhe i mbrojtën. Ky libër është një monografi e shkruar njëkohësisht dhe gjithë informacioni që jepet, është tejet i çmuar.

A. KADIU